

PËRCAKTORI

Përcaktori është gjymtyrë e dytë e fjalisë që hyn në marrëdhënie përcaktore me një fjalë emërore të fjalisë dhe lidhet me të me përshtatje, me drejtim dhe me bashkim. Përcaktori ka një pozicion të veçantë ndaj gjymtyrëve të tjera të fjalisë. Ai është pjesë e grupit emëror: ***Kurorae zjarrtë e diellit** preku majëne malit të Korabit.*

Ndërmjet përcaktorit si gjymtyrë fjalie dhe fjalëve përcaktuese ka dallim, sepse jo çdo fjalë që përcakton një fjalë emërore në fjali është përcaktor.

Në gjuhën shqipe emri në trajtën e pashquar ka një pamëvetësi kuptimore e strukturore për të funksionuar vetëm në fjali si një gjymtyrë fjalie. Që të luajë rolin e gjymtyrës së fjalisë, ai ka nevojë për një fjalë tjetër që mund të jetë *përemër dëftor*, *i pacaktuar apo edhe mbiemër* që specifikon këtë emër. Pikërisht këto fjalë specifikuese quhen fjalë përcaktuese dhe jo përcaktorë, sepse ato së bashku me emrin formojnë një togfjalësh që kryen funksionin e përcaktorit: ***Ky zjarr nuk dotë shuhet kurrë. Të ftohtët e këtij dimri është shumë i madh.***

Përcaktori mund të hiqet pa e prishur strukturën e fjalisë, kurse fjala përcaktuese jo.

P.sh.: *Dielli **i zjarrtë** po fundosej në detin e kaltër.* Provoni ta lexoni fjalinë duke hequr fjalët e ngjyrosura: *Dielli po fundosej në detin (?).....*

Pra: **i zjarrtë**- përcaktor i shprehur me mbiemër; **e kaltër**- fjalë përcaktuese.

Në bazë të llojit të lidhjes sintaksore (shih përkufizimin) do të dallohen:

a) përcaktori me përshtatje; b) përcaktori me drejtim; c) përcaktori me bashkim

a) Përcaktori me përshtatje

Përcaktori me përshtatje shprehet me mbiemër, me përemër dhe me numërorët *tre (tri), të dy, të tre* etj.

1. **Mbiemrat** si përcaktorë shprehin cilësi (tipare) të emrave a përemrave të pacaktuar me përdorim emëror: *asgjë, diçka, gjësendi, kurrëgjë etj.*

*Në mes të nofullave kishte një gropëtë **madhe**. Gishti **tregues** i ishte zverdhur nga nikotina. Diçka **e frikshme** po ndodhte. Nuk po bëjmë **asgjëtë madhe**.*

2. **Përemrat** (dëftorë, pronorë, si dhe disa përemra pyetës e të pacaktuar).

- **Dëftorë**: *ky, kjo, ai, ajo, i atillë, i këtillë, i tillë:*

*Pjesa më e madhe **e këtyre** njerëzve janë aktorë. Hyra në **atë** dhomë për qëllim tjetër. Luftën e fiton **ai** më trimi. Këta mund të luajnë role **të tilla**. Ai nuk hynte në **të tilla** gracka.*

- **Pronorë**: *E mbylli jetën **e saj** sterrë e pa dashuri. Djali **i tyre** që larguar prej vitesh. Kishin një njeri **të tyrin** në ministri.*

- Pyetës:*cili dhe i sati*. Shërbejnë për të pyetur për tipare të ndryshme të sendeve a frymorëve. Shoqërohen nga emra të pashquar: **Të satin**varg e ke? Me **cilin**shok po grindesh?
- Të pacaktuar *i gjithë, i tërë, tjetër*: **Të gjithë** njerëzit i kishin kthyer sytë nga ai. **E tërë**jeta i kaloi para syve. Fshatra **të tëra** janë mbuluar nga bora. Nuk zbriti asnjëri **tjetër**.

3. **Numërorët** *tre, tëdy, të tre*: **Tre** njerëz dukeshin e zhdukeshin te maja e bregut. Duhet bërë**tri** pengesa në shtratin e lumit. **Të tre** studentët vraponin për të kapur autobusin. **Tëdy** kritikët ulën kryet.

Kur numërorët *tëdy, të tre* bashkohen me përemrat dëftorët, *këta*, gjymtyra e përcaktuar dallohet nga përcaktori me ndihmën e rendit të fjalëve: fjala që vihet para është përcaktor: Nga **të dy** këta varej shumë. Fjala që vihet pas është fjalë e përcaktuar: Ata **të pestë** u tërhoqën pa folur. Ata = përcaktor.

b) Përcaktori me drejtim

Shprehet me:

1. me emër në rasën gjinore, kallëzore e rrjedhore pa parafjalë:

Hija **e malit** kishte rënë mbi fshat. Tufa **e fazanëve** u duk përsëri në anën tjetër **të pyllit**. Ora ishte katër **e pasdites**.

- Shembuj të përcaktorëve me emra në gjinore: fytyra **e plakut**, librat **e nxënësve**, halat **e pishave**, druri **i arrës**, lindja **e diellit**, ardhja **e babait**, marrja **e vendimit**, hapja **e derës**, dhoma **e pritjes**, shtëpia **e pushimit**, mollët **e Korçës**, fasulja **e Pejës**, shumica **e djemve**, tufa **e dhëve**, vargu **i njerëzve**, lumi **i Vjosës**, mali **i Dajtit** etj.
- Shembuj të përcaktorëve me emra në kallëzore:

Ky përcaktor tregon një karakteristikë duke shënuar: **a) Përmbajtjen**, kur lidhet me emra që tregojnë masë vëllimore, si: *shishe, gotë, thes, grusht, pjatë, lugë* etj.: një gotë**ujë**, një shishe **vaj**, një thes **miell**, një grusht **misër**, një pjatë**gjellë**, një lugë**mjaltë** ...

b) Tërësinë nga e cila veçohet një pjesë, kur varet nga emra, si: kilogram, metër, kafshatë, copë etj.: një kilogram **grurë**, dy metra **basmë**, një copë**djathë**

- Shembuj të përcaktorëve me emra në rrjedhore: natë**dimri**, ndjenja **gëzimi**, zë**djaloshi**, këngë**trimërie**, lule **qershie**, reçel **fiqsh**, fluturime **aeroplanësh**, zëmiku, shpejtësi **delfini**, vathë**argjendi**, unazë**ari**, mollë**Korçe**, dhomë**studimi**, shami **koke**, kope **dhensh**, karvan **kuajsh**, lukuni **qensh** etj.

2. me emër në rasën emërore, kallëzore e rrjedhore me parafjalë:

- Shembuj të përcaktorëve me emra në emërore: *Këtu do të ndërtohet një fabrikë* nga **më modernet**.

- Shembuj të përcaktorëve me emra nëkallëzore: *shportëme mollë, tufëme lule infermieret me përparëse, fjalëme vend; kafe pa sheqer, këngë pa shpirt, dasmëpa mish; lëvizja për çlirim, , dyqan për lodra, këpucëpër fëmijë, miq për kokë; shkollënë malësi, bora në male; toka nën ujë etj.*
- Shembuj të përcaktorëve me emra nërrjedhore: *shkallëprej druri, bluzëprej pambuku, xhup prej lëkure, fytyrëprej mashtruesi; bisedat rreth zgjedhjeve; detyra ndaj atdheut; myshqet rrëzë mureve etj.*

3. **me përemra:** *mendimi i të gjithëve, zëri i atyre, njërin prej tyre; asnjënga ju, cili nga ju, punëpër ne;*

4. **me togfjalësh:** *ndjenjat e kësaj moshe, agimi i atij mëngjesi, sëpata e ndonjë druvari, qilim bojë bari, lëkura ngjyrë kafeje, sytëbojë qielli, sy në formë bajameje etj.*

c) Përcaktori me bashkim

Shprehet me :

1. me përemra të palakuëshëm:

- Përemrat pyetës *ç*, *sae* rrallë *çfarë*, të cilët plotësojnë një emër të pashquar: *Ç' punë bëre sot? Samakina kaluan në rrugë? Çfarë vizatimi do të bësh sot?*
- Përemrat e pacaktuar *asnjë, çdo, ndonjë, disa, ca, pak, shumë, mjaft, kaq, aq, tërë, gjithë mbarë: Nëasnjë shkollë nuk ndodhin gjëra të tilla. Nuk mund të bisedohet me çdo njeri. A do të gjenin vallëndonjë punë? Ky është mendimi i shumë (disa, pak) njerëzve. Gjithë fshati kishte dalë për ta pritur. Lajmi tronditi mbarë fshatin.*

2. **me numërorë:** *Gjergj Elez Alia dergjej në shtrat me nëntë plagë. Doli jashtë dhe u thirri dy shokëve. Ato janëdy vajzat e mia.*

3. me forma të pashtjelluara të paskajores dhe të pjesores:

- Shembuj të përcaktorëve me paskajore: *dëshira për të ardhur, vullneti për të studiuar, shpresa për t'u kthyer, shteg për të shpëtuar, kostum për të qenë, fjalëpër t'u thënë etj.*
- Shembuj të përcaktorëve me pjesore: *Dy njerëz hipur mbi kuaj po kalonin në rrugë. E gjetën në mes të një are mbjellë me grurë.*

4. **me ndajfolje:** *vendi përreth, rruga djathtas, pylli përtej, ai atje, ne këtej etj.*

NDËJSHTIMI

Ndajshtimi është një lloj përcaktori i shprehur me emër të pashquar në rasën emërore që përshtatet në numër me gjymtyrën e përcaktuar. Përshtatja jo e plotë e dallon atë si një lloj i veçantë përcaktori: *popull mik, popullit mik, popullin mik, popujt miq, popujve miq; ushtar Agimi, ushtar Agimit, ushtar Agimin* etj.

Në bazë të fjalës që përcakton, dallohen dy lloje ndajshtimesh: ndajshtimi që përcakton një emër dhe ndajshtimi që përcakton një përemër vetor.

1. **Ndajshtimi që përcakton një emër** është lloji më i përhapur i ndajshtimeve. Ai mund të qëndrojë pas ose para gjymtyrës së përcaktuar.

Ndajshtimi që qëndron pas fjalës së përcaktuar mund të shprehet:

- *Me emër të përgjithshëm dhe tregon karakteristikë duke shënuar cilësi ose lloj:*

Zemra ime plagë u lëndua më tepër.Pula mëmë vërtitet rrotull duke mbledhur ushqim.

- *Me emër të përveçëm, pas një emri që tregon profesion, titull, detyrë shtetërore a shoqërore. Ndajshtimi tregon personin që ka këtë titull a profesion:*

Vetëm shkrimtari Adem Adashi nuk i dha ndojnë rëndësi sëmundjes diellore të shokut Zylo.Komandantin Rrapo nuk po e zinte gjumi.Mos e ka pikasur i dërguari Xhabir? Kur më vunë në të djathtë të bacës Azem, askush nuk u çudit.

- *Me emër të përveçëm gjeografik a emra që shënojnë titulin e një vepre letrare, gazete, emrat e institucioneve, rrugëve, lagjeve e njësive administrative të ndryshme etj.:*

Lumi Drin është lumi më i gjatë në Shqipëri.Poema "Këngët e Milosaos" u botua më 1836.Kështu hyra në kafe "Kursel".

- *Me një fjalë çfarëdo pas emrave fjalë, thirrje, emër, nocion, koncept duke u shënuar se cila është kjo fjalë, thirrjeetj.:*

Fjala shok ta ngroh zemrën.Është krenari të kesh emrin student.

Ndajshtimi që qëndron para fjalës së përcaktuar shprehet me emër të përgjithshëm të pashquar dhe tregon karakteristikë, duke shënuar përkatësinë fisnore, profesionin, detyrën, gradën a titullin. Ai përcakton një emër të përveçëm: **doktor** Besimi, **shofer** Agimi, **nënë** Mara, **profesor** Çabejietj.:

Atëhere m'u kujtua **profesor** Zuberi, një nga gjeologët më të mëdhenj të botës. **Doktor** Borova vuri dorën te balli i të sëmurit. **Kolonel** Hysenit vazhdonte t'i dridhej letra në dorë.

Këto ndajshtime ndërrojnë vend me fjalën e përcaktuar, pra të dyja elementet e togfjalëshit mund të dalin në funksion të ndajshtimit. Në këtë togfjalësh që ndërtohet nga një emër i përveçëm dhe një i përgjithshëm, theksohet emri në trajtën e shquar. Ndajshtimi, qoftë emër i përveçëm, qoftë emër i përgjithshëm, si gjymtyrë e rangut të dytë që është (si përcaktor), nuk theksohet: **kolonel** Hyseni – koloneli **Hysen**.

2.Ndajshtimi që përcakton një përemër vetor të vetës së parë dhe të dytë, ndryshe nga ndajshtimi që vjen pas një emri, shprehet me emër të shquar i cili përshtatet me gjymtyrën e përcaktuar në numër dhe në rasë. Ai saktëson folësin ose bashkëfolësin të shprehur nga përemri vetor:

Për jutë rinjtë demokracia hapi horizonte të reja. Neinxhinierët kemi bredhur në shumë kantiere.

Ndajshtimi pranë një përemri mund të shprehet edhe me një mbiemër të emëruar, me përemër të pacaktuar dhe me emër në rasën gjinore:

Netë mëdhenjtë dhe ju të vegjëlit e kemi të përbashkët rrugën. S'mbeti asgjë për netë tjerët. Jutë shkollës i kuptoni ndoshta edhe më mirë gjërat.

Ndërtimi *përemër vetor + emër* në funksion ndajshtimi formon një takt ligjërimor. Në rast të kundërt, kur midis tyre ka pauzë, kemi të bëjmë me ndajshtim të veçuar: *Për ju, **fëmijët**, tani e tutje do të ketë ditë të lumtura.*